

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: RamaPrint SH.P.K. me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	04.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **28.05.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **RamaPrint SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-2019-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-005-1-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **RamaPrint SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-2019-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-005-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **22.05.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-2019-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-005-1-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **RamaPrint SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-2019-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-005-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **22.05.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **28.05.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Në Ligjin e Prokurimit Publik, tek Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve ceket:

1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

1.1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;

Arsyetim: Departamenti kërkuese (Njësia kërkuese) është: **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**, dhe Drejtori i kësaj drejtorie është, *shih linkun nga Komuna:* <https://rahovec.rks-gov.net/drejtori-9/>, ku Komisioni vlerësues është informuar/njoftuar **se ka lidhje të ngushtë familjare me kompaninë në fjalë** dhe kjo bie ndesh me Nenin e cekur më lartë të LPP-së, po ashtu është në kundërshtim me **Ligjin Nr. 06/L-011** për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioni Publik;

Në përputhje me këtë analizë dhe bazuar në Ligjet përkatëse, oferta juaj eliminohet nga procedura e mëtejshme e vlerësimit;

Pretendimi nga Operatori Ekonomik Ankimor:

II. ARSYETIMI I KUNDËRSHTIMIT TË ELIMINIMIT:

Komisioni vlerësues ka konstatuar pa të drejtë se Operatori Ekonomik "RAMAPRINT SH.P.K." ndodhet në situatë të Konfliktit të Interesit sipas Nenit 65 të LPP-së dhe Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me pretendimin se ekziston një lidhje e ngushtë familjare me Drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Ne e kundërshtojmë fuqishëm këtë konstatim bazuar në pikat ligjore si në vijim:

1. Mos-përfshirja në rrethin e personave të afërt sipas ligjit:

Zyrtari i apostrofuar nga ana juaj është **djali i axhës (djali i vëllait të prindit)** të pronarit të kompanisë sonë. Sipas **Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Neni 4, paragrafi 1.6)**, person i afërt i zyrtarit konsiderohet vetëm: bashkëshorti/ja, partneri bashkëjetues, të parët dhe të pasmit në vijë të drejtë (prindërit/fëmijët), vëllezërit dhe motrat. Kushërinjtë e shkallës së dytë (siç është djali i axhës) **nuk përfshihen** në këtë ndalesë ligjore, për aq më tepër që nuk ndajmë të njëjtën bashkësi apo ekonomi familjare. Secili jeton në shtëpi dhe zhvillon ekonomi të ndara tregtare.

2. Mungesa e ndikimit dhe qasjes në proces:

Zyrtari i lartcekur **nuk ka qenë pjesëmarrës** në komisionin vlerësues të këtij aktiviteti të prokurimit, nuk ka pasur asnjë lloj qasjeje në vlerësimin e ofertave dhe asnjë mundësi ndikimi në përzgjedhjen e fituesit. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të Nenit 65.1.1 të LPP-së është tërësisht i paqëndrueshëm dhe i paargumentuar me asnjë dëshmi direkte apo indirekte nga ana e AK-së.

Përgjigje në Pretendimi Ankimor nga AK:


Pas shqyrtimit të **Kërkesës për Rishqyrtim** me pretendimet:

Ne e kundërshtojmë fuqishëm këtë konstatim bazuar në pikat ligjore si në vijim:

1. Mos-përfshirja në rrethin e personave të afërt sipas ligjit:

*Zyrtari i apostrofuar nga ana juaj është **djali i axhës (djali i vëllait të prindit)** të pronarit të kompanisë sonë. Sipas Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Neni 4, paragrafi 1.6), person i afërt i zyrtarit konsiderohet vetëm: bashkëshorti/ja, partneri bashkëjetues, të parët dhe të pasmit në vijë të drejtë (prindërit/fëmijët), vëllezërit dhe motrat. Kushërinjtë e shkallës së dytë (siç është djali i axhës) nuk përfshihen në këtë ndalesë ligjore, për aq më tepër që nuk ndajmë të njëjtën bashkësi apo ekonomi familjare. Secili jeton në shtëpi dhe zhvillon ekonomi të ndara tregtare.*

Pretendimi juaj është **I pabazuara**: Departamenti kërkues (Njësia kërkuese) është: **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**, dhe Drejtori i kësaj Drejtorie është:

Departamenti kërkues:	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
Zyrtari kërkues:	ATDHE RAMA
Data:	01.04.2026
Nënshkrimi i personit kërkues	

Ku në pretendimin tuaj keni pranuar se është **djali i axhës (djali i vëllait të prindit)**, dhe kjo është në kundërshtim me **Nenin 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve**, Ligjit të Prokurimit Publik, i cili nen e kemi cekur tek **Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**;

Po ashtu **Neni 4 Përkufizimet** i Ligjit për Prokurim Publik, thotë: **Konfliktet e interesit** - çdo situatë ku **anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues** ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që **vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit** ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure **kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal** financiar, ekonomik **apo ndonjë interes tjetër** që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit.

Në pretendimin tuaj po ashtu keni cekur: *Zyrtari i lartcekur nuk ka qenë pjesëmarrës në komisionin vlerësues të këtij aktiviteti të prokurimit, nuk ka pasur asnjë lloj qasjeje në vlerësimin e ofertave dhe asnjë mundësi ndikimi në përzgjedhjen e fituesit. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të Nenit 65.1.1 të LPP-së është tërësisht i paqëndrueshëm dhe i paargumentuar me asnjë dëshmi direkte apo indirekte nga ana e AK-së.*

Pretendimi juaj është I pabazuara: Në rastin konkret Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, përpos inicimit të aktivitetit të prokurimit ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e Specifikave teknike (përshkrimit të çmimeve),

dhe në argumentin tuja se drejtori nuk ka qenë anëtar i komisionit vlerësues nuk e zgjidh domosdoshërisht problemin. Konflikt interesi mund të lind **edhe para fazës së inicimit të aktivitetit të prokurimit**, veçanërisht gjatë përgatitjes së specifikave teknike (përshkrimit të çmimeve);

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>